Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Lulzim Bajrami	**11.08.2023**	**18.08.2023**	**2023/0563**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 10.08.2023, OE "**Ex Fis"**- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0563, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Ex Fis"- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)"** me nr. të prokurimit: **"KEK-23-6766-1-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **4,200,000.00 €**.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0563 i dt:10.08.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Me rastin e vlerësimit të ofertave për këtë tender AK ka vepruar në kundërshtim me LPP-së respektivisht Neni 6 paragrafi 1, Neni 7 paragrafi 1, Neni 24 paragrafi 2, Neni 56 paragrafi 1 pika 1.1 dhe 1.2, Neni 59 paragrafi 3 dhe 4, neni 65 paragrafi 3 pika 3.1 deri 3.6 dhe paragrafi 4 pika 4.1 deri 4.11, Neni 69, paragrafi 2 pika 2.1 dhe neni 72. Po ashtu raporti i vlerësimit të ofertave të këtij tenderi është në kundërshtim edhe me Rregulloren nr. 01/2022 për Prokurim Publik, respektivisht Neni 4 paragrafi 4.3 pika (c), Neni 25 paragrafi 25.1 pika (b), paragrafi 25.4, paragrafi 25.5, paragrafi 25.6 (b), dhe paragrafi 25.9, Neni 38 paragrafi 38.3, 38.4 dhe 38.5, Neni 40 paragrafi 40.6, dhe 40.7, neni 45 paragrafi 45.17, 45.18, 45.20, 45.21, 45.30 dhe 45.31.

Vërejtjet e OE EX FIS shpk, lidhur me raportin e vlerësimit te ofertave për ketë tender janë si më poshtë:

Pas analizimit të plotë të të gjitha dokumenteve të këtij tenderi, raportin e vlerësimit dhe dokumenteve shtese te përshtatshmërisë, ofertën e OE Patroni, është vërtetuar se oferta e OE Patroni shpk është e pa përgjegjshme dhe nuk i plotëson kërkesat minimale të DT-së dhe Njoftim për kontratë, si dhe procesi i vlerësimit dhe raporti i vlerësimit si tërësi nuk është ne përputhje me LPP dhe Rregulloren nr. 01/2022, për këto arsye, si:

1. Vërejtja e parë lidhur me:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	Neni 9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe profesional:**	Dëshmia e kërkuar dokumentare
		1. **Projektet e realizuara brenda 3 viteve te fundit;**	1. **Listën e furnizimeve te ngjashme (derivateve) të operatorit ekonomi realizuara, duke saktësuar produkt furnizuara, shumën e kontratës, da pranuesit;**

Nëse i analizojmë listën e kontratave dhe referencave të ofruar nga ky i OE kemi ketë pasqyre:

Lista e furnizimeve te realizuara ne 3 vitet e fundit (2019, 2020, 2021)

NR.	Titulli i kontrates	Produket e furnizuara	Shuma e Kontrates	Data	Pranuesi
1	Kontrat per shitje te derivateve	Naft dhe Benzine	14,768,636 €	01.01.2019-30.04.2022	Patroni NTSH
3	Kontrat per shitje te derivateve	Bitumen, Mazut, Naft dhe benzine	1,797,524.72€	01.01.2021-30.04.2022	ETI SHPK
4	Kontrat per shitje te derivateve	Bitumen, Mazut, Naft dhe benzine	949,544.45€	21.04.2021-21.04.2022	Haxha Company
5	Kontrat per shitje te derivateve	Bitumen, Mazut, Naft dhe benzine	698,903.77€	01.01.2019-30.04.2022	Eko Clean SH.P.K
7	Kontrat per shitje te derivateve	Naft dhe Benzine	638,296.36 €	01.01.2019-13.06.2022	Carbona Petrol
8	Kontrat per shitje te derivateve	Naft dhe Benzine	1,632,670€	01.01.2019-13.06.2022	Oil Petrol

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Ankes dhe nëse vertetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një oferte e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë atë në listen e zezë te Operatoreve Ekonomik.

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____

Vula _____

PATRONI

Vërejtjet dhe mospërputhjet e të dhënave te kësaj liste me listën e kontratave te bashkangjitura ne dokumentin e OE nr. 7.1 Lista e furnizimeve te realizuara ne 3 vitet e fundit (2019, 2020, 2021):

1. Kontrata e prezantuar mes OE Patroni NSH, ETI shpk, EKO CLEAN shpk, Carbon Petrol dhe Oil Petroll fillojnë dhe përfundojnë ne te njëjtat data, çka ne këto raste tek operatoret private është e pa mundur dhe e pa arsyeshme, dhe len dyshimin e një dokumenti fiktive, shto këtu edhe faktin që data 01.01 është dite feste, pra dita e parë e vitit.

2. Po ashtu kohëzgjatja e kontratave e prezantuar ne këtë liste nuk përkon me kohëzgjatjen e kontratave te prezantuara, si:

- Kontrata me OE Partoni NSH, ka kohëzgjatje prej 3 viteve, çka do te thotë se afati i përfundimit te kontratës është data 31.12.2021, e jo si e ka përshkruar OE datën 30.04.2022, pra mungon dëshmia e aneksit apo kohëzgjatjes se kontratës;

- Kontrata me OE ETI shpk, ka kohëzgjatje prej 3 viteve, çka do te thotë se afati i përfundimit te kontratës është data 31.12.2021, e jo si e ka përshkruar OE datën 30.04.2022, pra mungon dëshmi apo aneksi për Page 4 of 7 ndërprerjen e kësaj kontratave. Po ashtu si date e lidhjes se kësaj kontrata figuron data 01.01.2018, e jo data 01.01.2019 si e ka prezantuar OE i propozuar për kontratë.

- Kontrata me OE Haxha Company, ka kohëzgjatje pre 1 viti, por kjo kontrate ka mos përputhje me datën e nënshkrimit dhe datën e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontrate, sepse ne kontrate si date e kontratës figuron data 01.01.2021 ndërsa OE i rekomanduar ne liste e ka prezantuar si date te kontratës datën 21.04.2021.

- Kontrata me OE ECO CLEAN shpk, ka kohëzgjatje prej 4 viteve, çka do te thotë se afati i përfundimit te kësaj kontrate është data 31.12.2022, e jo si e ka përshkruar OE datën 30.04.2022, por ajo që vë ne dyshim këtë kontrate është fakti se edhe pse ne faqen e par si datë e kontratës figuron data 01.01.2019, tek nënshkrimi i kontratës pjesa e OE Eco Clean si data e nënshkrimit të kësaj kontrate figuron data 01.01.2021, pra OE i rekomanduar për kontrate parqet si kontratë te realizuar nga viti 2019 një kontratë që e ka nënshkruar në vitin 2021.

- Kontratat e nënshkruar me OE Carbona Petrol dhe Oil Petrol, kanë kohëzgjatje prej 3 viteve, çka do te thotë se afati i përfundimit te tyre është data 31.12.2021, e jo si e ka përshkruar OE datën 13.06.2022, pra mungon dëshmia apo aneksi për kohëzgjatjen e këtyre kontratave.

3. OE Patroni shpk, për ketë pikë ka ofruar një liste të kontratave të cilat kanë nevojë të sqarohen para se te pranohen si te tilla. Sepse OE ka prezantuar një listë të kontratave prej 6 kontratave ku 5 nga këto kontrata fillojnë me te njëjtën datë dt. 01 janar, dhe katra prej tyre edhe ne vitin e njëjtë viti 2019 dhe një tjetër ne vitin 2021, pra ditën e pare te vitit 2019 dhe 2021, kur dihet se data 01.01 është dite pushimi për te gjitha institucionet e edhe për kompanitë private.

Pra AK duke mos i sqaruar dhe verifikuar këto kontrata por duke i marre te mirëqena ka vepruar ne kundërshtim me LPP neni 72 dhe Rregulloren nr. 01/2022 Neni 38 paragrafi 38.3, 38.4 dhe 38.5, sepse me vetëdije ka pranuar një liste te koftrave që duken se janë shume fiktive, pa i verifikuar ashtu si kërkon LPP dhe Rregullorja. AK duke i pranuar ketë liste te kontratave si te mirëqenë dhe te mjaftueshme për kërkesat e DT-së ka vepruar me vetëdije ne kundërshtim të plotë me LPP, sepse ka qen i bindur se lista e kontratave nuk i plotëson kërkesat ligjore ashtu si ceket në neni 69 paragrafi 2 pika 2.1, nënpika (ii) ku thuhet po citoj: "kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë" mbyllet citati.

Prandaj, nëse i referohemi datave fiktive të këtyre kontratave, mospërputhjes mes datave te kontratave dhe nënshkrimit, kohës se përfundimit dhe kohëzgjatjes se tyre, mungesës se dëshmive ashtu si kërkon LPP nenin 69 pika 2.1, mos sqarimit nga ne AK-se etj. e bene ketë liste të pamjaftueshme për te plotësuar kërkesat e DT pika 9.1&9.2, dhe si e tillë kjo listë e kontratave për tu pranuar duhet së pari te sqarohet dhe vërtetohet saktësia e tyre sipas kërkesave ligjore.

2. Vërejtja e dytë lidhur me RAPORTIN E VLERËSIMIT;

Raporti i vlerësimit, ne faqen nr. 11 pjesa "Dëshmitë lidhur me kërkesat e përshtatshmërisë", figuron se kërkesat e përshtatshmërisë si kërkohen ne FDT nenin 6.4 pik 2 dhe 3 janë përmbushur nga OE i rekomanduar për kontratë me datë 24.07.2023 dhe me datë 25.07.2023 datë kur ZPP z. Ymer Dragusha e ka nënshkruar dhe aprovuar raportin e vlerësimit dhe rekomandimin e komisionit të vlerësimit duke vërtetuar se OE i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar këtë gjitha kërkesa te DT-se.

Ndërsa bazuar në dëshmitë e dorëzuar nga KEK sha (referoju emailit te z. Bledar Racaj bartës i lendes nga zyra e prokurimit) figuron se KEK sha ju ka drejtuar OE Patroni me dt. 01.08.2023 për te dorëzuar këto dëshmi, ndërsa mbështetur ne origjinalet e këtyre dokumenteve figuron se këto dokumente janë nxjerr me datë 01.08.2023, dhe si duket janë dorëzuar po me ketë date te AK.

Nga këto dëshmi vërtetohet se AK respektivisht ZPP ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë pas 7 dite që ka marr vendimin për shpërblim me kontratë te plotësoj kërkesat e përshtatshmërisë ashtu si kërkohen ne FDT Page 5 of 7 neni 6.4 pika 2 dhe 3, pra duke vepruar në ketë mënyrë ZPP ka vepruan ne kundërshtim me Rregulloren nr.1/2022 Neni 25 paragrafi 25.9 dhe Neni 45, paragrafi 45.31 dhe 45.32.

3. Vërejtja e trete lidhur me Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Komerciale;

ZPP ka pranuar si te mirëqenë dokumentin e OE Patroni te lëshuar nga Gjykata Komerciale e Kosove me nr. GjA.nr. 4574-23 dt. 01.08.2023, pa e analizuar dhe verifikuar nëse dokumenti i plotëson kërkesat e DT te përcaktuar në FDT neni 6.4 pika 3.

Nëse e analizojmë ketë dokument dëshmohet se Gjykata Komercial e ka lëshuar garanci vetëm për paragrafin 4 nën paragrafin 4.1 dhe 4.2 te Nenit 65, dhe nuk jep as një dëshmi apo garancion për kërkesat e paragrafit 3 te nenit 65, ashtu si kërkohet edhe ne FDT neni 6.4 pika 3.

Prandaj, përveç se ZPP ka vepruar ne kundërshtim me LPP me rastin e aprovimit te raportit te vlerësimit pa pranimin e këtyre dëshmive, ZPP ka vepruar edhe ne kundërshtim te plote me LPP neni 59 paragrafi 4, neni 65 paragrafi 3 dhe 4 si dhe Rregulloren nr. 01-2022 neni 25 paragrafi 25.1 pika (b), paragrafi 25.4, paragrafi 25.6 pika (b), dhe neni 40 paragrafi 40.6 dhe 40.7.

Prandaj si i tillë ky dokument nuk plotëson kërkesat e DT-se te përcaktuara ne FDT neni 6.4 pika 3, dhe si rrjedhoje edhe oferta e OE për ketë pike është e pa përgjegjshme dhe AK do te duhej ta shpallet e ketë oferte si te pa përgjegjshme dhe ta eliminonte nga gara.

4. Vërejtja e katërt lidhur me kapacitetet teknike:

Te Aneksi-1 tabela e parë paragrafi 3, kërkohet: "Fituesi potencial duhet të ketë kapacitete

teknike për liferimin e 250 tonëve për 5 ditë, në rastet emergjente 500 ton".

Ndërsa bazua ne dëshmitë që AK na ka dorëzuar me rastin e qasjes ne dokumentet e këtij tenderi dhe ofertën e OE të propozuar për kontratë, ne nuk kem pranuar apo parë as një dokument me të cilin AK ka verifikuar kapacitet e OE te propozuar për kontratë, se janë të mjaftueshme për te plotësuar ketë kërkesë. Po ashtu as ne dokumentet e ofertës se OE Patroni nuk figuron ndonjë dokument apo dëshmi me te cilin OE dëshmon kapacitet e tij transportuese. Sipas kësaj kërkese OE fitues duhet te posedoj se paku 2 cisterna me 25 ton kapacitet për bartjen e mazutit, dhe se paku edhe 2 te tjera rezerve për te plotësuar ketë kërkesë të AK-së. Dhe atë me kushte që këto automjetet te jenë të destinuar vetëm për kontratën e KEK sha.

Prandaj AK duke vepruar ne ketë mënyrë ka vepruar ne kundërshtim me LPP nenin 59 dhe Neni 72 si dhe Rregulloren nr. 012022 neni 38. Sepse AK do të duhej te sqaronte ketë kërkesë me OE duke i kërkuar sqarime shtesë, për tu vërtetuar se OE i propozuar për shpërblim me kontratë posedon këto kapacitet për te plotësuar furnizim me kohe dhe sigurt.

5. Vërejtja e pestë, lidhur me deklaratat:

Në Aneksin-1, AK ka kërkuar po citoj "OE përmes një deklarate duhet te deklarohet lidhur me vendin e origjinës se Mazutit dhe Prodhuesin" mbyllet citati.

Ndërsa ne paragrafin e fundit të Aneksi-1 AK ka specifikuar, po citoj "Tenderuesi duhet të jetë në pajtueshmëri me të gjitha specifikimet e shënuara në këtë listë. Çdo kërkesë jo e përmbushur do të eliminojë tenderin për pjesën e plotë. Ju lutem kontrolloni nëse tenderi juaj plotëson secilin nga specifikimet teknike të përshkruara më lartë" mbyllet citati.

Page 6 of 7 Bazuar nga qasja qe ne kem pasur ne dokumentet e këtij tenderi si dhe ofertën e OE Patroni, ne nuk kem hasur se OE ka dorëzuar këtë deklaratë, apo ndonjë dëshmi tjetër ekuivalente qe do e përmbushë këtë kërkesë te DT-se.

Ndërsa ne kërkesën ton për ri shqyrtim te vendimit dt. 04.08.2023 lidhur me ketë pikë AK na është përgjigjur, po citojmë: "OE i propozuar për kontrate ne ofertën e tij ka dorëzuar edhe një dokument me analiza fiziko-kimike ne te cilin kuptohet vendi dhe origjina e lendes djegës-Mazutit" mbyllet citati.

Dokumenti te cilit i referohet AK, nuk e plotëson kërkesën e AK për Aneksin-1, DEKLARAT për te dëshmuar vendin e origjinës se Mazutit dhe prodhuesin. Sepse ky dokument është një Certifikatë e Kualitetit te cilën e ka lëshuar laboratori MAKINSPECT doo, Shkup, për OE Patroni shpk, qe dëshmon vetëm metodat e përdorura për analiza te një sasie prej 25.719 kg (ose 26,930 litra) Mazut qe OE Patroni shpk e ka blere dhe ngarkuar ne HELPE lonia, Thesaloniki.

Ne ketë certifikatë nuk cekëte as shitësi dhe as prodhuesi i mazutit. Si e tillë kjo certifikatë nuk e garanton as kualitetin e mallit te ofruar nga OE Patroni sipas kërkesave te DT-se, Aneksi□1, tabela e dyte, sepse kjo certifikatë i referohet një sasisë te caktuar mazuti te blerë (sasia prej 26,930 lirave) qe OE Patroni e ka blerë me dt. 19.07.2023 dhe e ka destinuar ne një vende tjetër dhe jo për KEK sha.

Kur merret parasysh që OE Patroni nuk ka paraqitura fare Deklaratën për te dëshmuar vendin e origjinës se Mazutit dhe prodhuesin, apo edhe ndonjë dëshmi tjetër ekuivalente si autorizim apo

marrëveshje me ndonjë prodhues qe do të plotësonte kërkesën e deklaratës, është plotësisht e qarte qe OE i rekomanduar nuk mund të paraqes as certifikatë valide mbi kualitetin e mallit, e cila plotëson kërkesat teknike te Ankesit-1. Prandaj si e tillë kjo certifikatë jo vetëm që nuk mund te merret si dokument ekuivalent për te plotësuar Deklaratë mbi vendin e origjinës se Mazutit dhe prodhuesin, por nuk mund e merret as si dokument valid për te dëshmuar karakteristikat e mallit sipas Aneksit -1 tabela e dytë. Prandaj AK gjate vlerësimit do te duhej qe ofertën e OE ta shpallte si te pa përgjegjshme ne aspektin teknik sipas kërkesave te Aneksit-1 dhe fare mos ta marr për baze gjate vlerësimit e jo te e rekomandonte për shpërblim me kontrate.

AK duke vepruar ne këtë mënyrë, dhe pranuar si te mirëqenë dhe te përgjegjshme ofertën e OE Patroni për këtë pikë ne mungesë te dokumenteve te kërkuara ne DT, ka vepruar ne kundërshtim me LPP neni 59, paragrafi 4 dhe Rregulloren nr. 01/2022 neni 25 paragrafi 25.1, 25.4 dhe 25.5, neni 40 paragrafi 40.6 dhe 40.7 dhe neni 45 paragrafi 45.17 dhe 45.18.

6. Vërejtja e gjashtë lidhur me çmimin:

Bazuar ne ofertën financiare te OE Patroni, vërehet një dallim shumë i madhe ne çmimin e primit mes ofertës tone dhe ofertës se OE te rekomanduar për kontratë.

Mbështetur ne faktet qe ne i kem dorëzuar ne ofertën tonë me te cilat dëshmohet se OE EX FIS shpk është operatori i vetëm i autorizuar nga Rafineria OKTA shkup, për shitjen e mazutit për KEK sha, si dhe çmimit te cilin ne e kem te kontraktuar me ketë rafineri, deklarojmë me përgjegjësi te plote (çka mund te e dëshmojmë me dokumente origjinale, ne seancën para panelit) (kërkojmë falje por për arsye qe kontrata qe kem me OKTA dhe dokumentet tjera janë sekret afarist nuk mund te ju dërgojmë me ketë anekse), se çmimi i ofruar ne OE Patroni është jo□normalisht i ultë.

Mirëpo kur merret parasysh qe OE Patroni nuk ka dhënë as një dëshmi mbi prejardhjen e mallit si dhe prodhuesin kjo lënë hapësirë dyshuese edhe me te madhe për këto çmime.

Prandaj AK do të duhej te i kërkonte sqarime dhe deshifrim te çmimit nga OE Patroni, sepse oferta e OE Patroni është për 39.635% më e lire se oferta e OE EXFIS shpk

Vërejtjet përmbyllëse:

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet qe u cekën më lartë mund te konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me Ligjin për Prokurim Publik dhe Rregulloren nr. 01/2022 për Prokurim Publik. Sepse AK ka rekomanduar për shpërblim me kontratë një ofertë të papërgjegjshme e cila nuk i ka plotësuar kërkesat minimale të dosjes se tenderit respektivisht FDT-se dhe Aneksit -1.

AK respektivisht ZPP-ja me rastin e vlerësimit të ofertave për ketë tender ka vepruar ne kundërshtim edhe me nenin 6 të LPP-së, duke mos u siguruar që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike dhe efikase, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ne kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, pasi që nuk i ka trajtuar OE pjesëmarrës në ketë tender në mënyrë te barabartë, duke favorizuar ofertën e OE PATRONI dhe diskriminuar ofertën e OE EXFIS shpk, si dhe ne kundërshtim me LPP neni 24 paragrafi 2 dhe neni 56 paragrafi 1, si dhe Rregulloren nr.01/202 neni 45 paragrafi 45.17, 45.18,

45.20 dhe 45.21.

Prandaj, bazuar në të gjitha këto shkelje dhe devijime të faktuara, që AK me ose pa qellim ka lëshuar gjatë udhëheqjes dhe vlerësimit të këtij tenderi ne kërkojmë nga OSHP si organ kompetente dhe i autorizuar nga ligj që të nxjerr;

VENDIM APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE EX FIS shpk;

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për shpërblim me kontratë datë 01.08.2023 dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM.**

KRITERET PËR VLERËSIM

Kriteri i vlerësimit sipas Dosjes se denderit pikë 31.1 ka qenë Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët , lloi i procedurës procedurë e hapur.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

DEKLARATË

Komisioni i vlerësimit pas kontrollit dhe verifikimi te ofertave konkurruese për aktivitetin e prokurimit: FUR
KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%), me numër te prokurimit KEKO-23-045-111, ka ardhur ne përfundim se
PATRONI SH.P.K., 811254797 i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe komisioni propozon q
shperblehet me kete kontrate. Komisioni i vlerësimit rekomandon zyrtarin përgjegjës te prokurimit qe operato
811254797 te shperblehet me kontrate dhe ate me cmimin e ofertes 4,699,058.45 Euro me TVSH ndersa cmi
Euro.

Tenderi është udhëhequr duke respektuar dispozitat e LPP-së Nr. 04/L-042 Ligji për Prokurimin Publik në K
ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Rregullores për Prokurimit Publik, Udhëzues

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Nuk ka pasur

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Nuk ka pasur vendime të mëparëshme nga PSH.OSHP lidhur me këtë rastë

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

Nuk ka pasur devijime.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Ex Fis**

Duke pasur parasysh pretendimet ankimore te operatorit ekonomik, ne cilësin e ekspertit shqyrtues do të përgjegjemi veç e veç lidhur me së cilin pretendim te ngritur. Përgjegjiet e ekspertit shqyrtues do të bazohën ne legjislacionin ne fuqi të prokurimit publik rregullave dhe direktivavev te tij si dhe kriteret e dosjes se tenderti dhe zhvillimit te procedurës se prokurimit.

Përgjegjie e ekspertit shqyrtues dhe shtjellimi i pretendimit ankimor nr.1, lidhur me „Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale "

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional** **1.Projektet e realizuara brenda 3 viteve te fundit;**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1.Listën e furnizimeve te ngjashm (derivateve) të operatori ekonomik të realizuara, duk saktësuar produktet e furnizuara shumën e kontratës, datën dh pranuesit.**

Bazuar në kriterin e dosje se tenderit Autoriteti Konktraktues , nuk ka cekur se sa kontrakta duhet të ken operatoret ofertues por vetë duhët të kenë Projekte te realizuara brenda 3 viteve te fundit (panvarsisht 1,2,3 apo sa).

Operatori ekonomik i rekomanduar **„Patroni SHPK"** në dosjen e tenderit, ofertës ka prezantuar listën e kontratave dhe kontratat e nënshkruara. Lista e kontratave përbëhet prej gjithsejt tetë (8) kontrata si në vijim:

Lista e furnizimeve te realizuara ne 3 vitet e fundit (2019, 2020, 2021)

NR.	Titulli i kontrates	Produket e furnizuara	Shuma e Kontrates	Data	Pranuesi
1	Kontrat per shitje te derivateve	Naft dhe Benzine	14,768,636 €	01.01.2019-30.04.2022	Patroni NTSH
3	Kontrat per shitje te derivateve	Bitumen, Mazut, Naft dhe benzine	1,797,524.72€	01.01.2021-30.04.2022	ETI SHPK
4	Kontrat per shitje te derivateve	Bitumen, Mazut, Naft dhe benzine	949,544.45€	21.04.2021-21.04.2022	Haxha Company
5	Kontrat per shitje te derivateve	Bitumen, Mazut, Naft dhe benzine	698,903.77€	01.01.2019-30.04.2022	Eko Clean SH.P.K
7	Kontrat per shitje te derivateve	Naft dhe Benzine	638,296.36 €	01.01.2019-13.06.2022	Carbona Petrol
8	Kontrat per shitje te derivateve	Naft dhe Benzine	1,632,670€	01.01.2019-13.06.2022	Oil Petrol

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Ankes dhe nëse vertetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një oferte e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë atë në listen e zezë te Operatoreve Ekonomik.

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____

Vula _____

PATRONI SH.P.K

Sa i përket pretendimit se kontratat kanë përfunduar para datëse se afatit te tyre sqarojm se kontratat ne baze te LPP dhe RRPP përfundojn ne momentin që arrihen sasit e furnizimeve ose arrihet vlera e kontratës panvarsisht kësaj se deri ne cilen dat kan a afat kontrata po ashtu e njeta gjë vlenë edhe për kontratat e lidhura me sektorin dhe nga sektori privat.

Mbeshtetur ne kërkesën e AK te cekur ne dosjen e tenderit lista e kontratave plotëson kriterin

e kërkuara po rithekesojm edhe njëher kërkesën 1. Listën e furnizimeve te ngjashme (derivateve) të operatorit ekonomik të realizuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit, bazuar ne këtë lista e kontratave përmban, lloin e furnizimeve, produktin e furnizimit, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin ne baze te kësaj konstatoj se operatori ekonomik plotëson kërkesat e dosjes se tenderti si dhe Nenin 69 te LPP-se andaj konstatojm se pretendimi ankimore ne këtë pikës është i **pa bazuar.**

Sa i përkthet dyshimeve ne vërtetësin e dokumenteve, kontratave kjo nuk është në kompetencat e ekspertit shqyrtues por është përgjegjësi e autoritetit kontraktues.

Përgjegjie e ekspertit shqyrtues dhe shtjellimi i pretendimit ankimor nr. 2. Raporti i Vlerësimit dhe pretendimet ankimore nr.3, lidhur me „ Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Komerciale"

Autoriteti kontraktues konform LPP Nenit 65 si dhe kërkesës se dosjes se tenderit sa i përket kërkesave te përshtatshmëris ka kërkuar:

Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1.Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 Neni 65;	**1.Një deklarata nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit;**
2.Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit;	**Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmrisë, pika 2, dhe 3 do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet.**
3.Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë" Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – origjinal ose kopje e noterizuar .- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit;	

Dokumnetet, Certifikata nga Gjykata dhe Vërtetimi tatimorë , kërkohen vetëm për operatorin ekonomik fitues ne rastin e shpalljes se rezultatit te prokurimti, në rastet kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive,

apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme, duhetë pasur parasysh se operatoi ekonomik ka në ofertë ka dorzuar edhe Deklaratën nënbetim, panvarsisht kësaj operatori ekonomik sëbashku me ofertën ka dorzuar edhe Vërtetimin Tatimor dhe Cërtifikatën nga gjykata (te nxerrur nga e-kosova ne emrin e pronarit sipas certifikatës se biznesit) si edhe Deklaratën nënbetim konform Nenit 65 te LPP. **(shih listen e dokumenteve te gjenerauara ne formularin e tenderit)**

Tituli: FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)

1	**FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)**

Kodi i tenderit: kek 19.07.2023

Data: 19.07.2023

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	2.1 Vertetimi tatimor.pdf
2.	2.NUI,TVSH-Patroni sh.p.k.pdf
3.	3.Licenca e trasnportit dhe mazutit.pdf
4.	7.1 Lista e furnizimeve te realizuara ne 3 vitet e fundit (2019, 2020, 2021).pdf
5.	7.Kontratat e furnizimeve.pdf
6.	9.2Sigurimi i tenderit.pdf
7.	9.3Dokumenti nga Gjykata.pdf
8.	9.Okta specifikat e analizes.pdf
9.	12.Deshmia nga MTI per licenc.pdf
10.	Aneksi 1 - Specifikimet teknike te detyrueshme.pdf
11.	Aneksi 2 - Deklarata nen betim.pdf
12.	Aneksi 3 - Kerkese per konfidencialitet.pdf
13.	Aneksi 5 - Kerkesa per informacione shtese.pdf
14.	Deklarata 2.pdf
15.	Deklarata per Aneksin 1.pdf
16.	PJESA V E KONTRATE´S IDENTIFIKIMI FINANCIAR.pdf

Në bazë te RRPP nr.001/2022, Nenit 25, pikës 25.9 Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo mëshumë se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës.Autoriteti kontraktues konform shkreses (e-mailit) me datën 01.08.2023 ka kërkuar nga ana e operatoirt ekonomik qe ti sjell dokumentet (Vertetimin tatimor, Certifikaten e gjykatës dhe Sigurimin e tenderit) fizikisht ne zyret e KEK-ut.

Shih kerkesesn (e-mailin) e Prokurimit ne KEK drejtuar Operatorit ekonomik „Patrnoni SHPK"

Bledar Racaj

From: Bledar Racaj
Sent: Tuesday, August 1, 2023 9:38 AM
To: 'info@patroni-ks.com'; 'driton-morina@hotmail.com'
Cc: Mirvete Gerguri
Subject: FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%), KEKO-23-260-111.

Te nderuar,

Lidhur me oferten tuaj te dorezuar per aktivitetin e porkurimit: FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%), KEKO-23-260-111.

Ju lutem qe te sjellni ne KEK- ZEP dokumentet e meposhtme:

- vërtetimin e lëshuar nga gjykata kompetente që nuk jeni nën hetime (origjinalin ose kopjen e noterizuar).

- vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës].

- Origjinalin e Sigurimit te tenderit (kopjen e te cilit e keni dorëzuar me ofertën elektronike).

Me respekt,

Bledar A. Racaj

Zyrtar i Lartë i Prokurimit

Bazur ne kërkesën e AK operatori ekonomik i rekomanduar figuro qe dokumentet e kerkuara i ka sjellur ne AK brenda afateve ligjore te percaktuara konform kërkesës. AK-KEK, publikimin e Njoftimin mbi vendimin e ka bër konform dokumenteve te prezantuara ne ofert lidhur me Vertetim tatimor dhe Certifikatene Gjykatës (te gjeneruar nga e-kosova ne emerin e pronarit te biznesit), e cila është konform paragrafit 3 te Nenit 65 te LPP-së pasi që pronari ka dëshmuar se nuk ka ndonje veper penale ose civile ndaj tij **(shih certfikaten nga gjykata).**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

SISTEMI QËNDROR I EVIDENCES PENALE TË KOSOVES

Nr.ser. 164ADEB4F94F463
Ser.br.
Ser.no.

CERTIFIKATË MBI DENIMET PENALE

Sistemi Qendror i Evidencës Penale i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 491 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, nenit 98 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nenit 7 par.1 pika 1.21 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenet 5, 6, 25 dhe 26 të Rregullores Nr.11/2022 Për Evidencën penale të Republikës së Kosovës, duke vepruar sipas kërkesës:

V Ë R T E T O N

Driton, Morina, me nr. personal te identifikimit 1016151358, i/e lindur me 06.05.1982 në Joviq i/e gjinisë Mashkull, nga i ati Habib Morina dhe e ëma Ferdije Morina, Shtetas i Kosovës.

NUK ËSHTË I DENUAR ME AKTGJYKIM TË FORMËS SË PRERË

Kjo Certifikatë do të përdoret për: Tender

Nënshkruesi/Potpisnik/Signatory	KGJK/SSK/KJC	
Data/Datum/Date	19/07/2023 10:31:54	
Ky dokument është nënshkruar në formë elektronike. Ovaj dokument je elektronski potpisan. This document is signed electronically.		https://eksova.rks-gov.net/kgjk

Po ashtu gjatë kërkesës se AK për ti sjellur dokumnetet sipas kerkess se dates 01.08.2023 (shih e-mailin me lart) i njeti ka derguar edhe Certifikaten nga Gjykata ne emrin kompanis qe dëshmon e se njeta nuk ka ndonje ndales ligjore ndaj kompanis ne fjalë **(shih Certifikaten nga gjykata)**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE
PRIVREDNI SUD – COMMERCIAL COURT

GjA.nr.4574-23
01.08.2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, në bazë të kërkesës së palës në kuptim të Rregullores Nr.07/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Komerciale të datë 29.07.2022, lëshon këtë: *PRIVREDNI SUD KOSOVA, na osnovu zahteva stranke u smislu Uredbe 07/2022 o Unutrašnjoj Organizaciji i Sistematizaciji Radnih, Mesta u Privrednom Sudu od 29.07.2022, izdaje ovo:*

ÇERTIFIKATË
UVERENJE

Në regjistrat e Gjykatës Komerciale të Kosovës, *U registrima Privrednog suda Kosova* Nuk ka - evidencë se operatori ekonomik **PATRONI SH.P.K – FUSHË KOSOVË** me numër të regjistrimit **811254797** është - shpallur i falimentuar ose insolvent gjatë dy (2) viteve të kaluara, dhe se ndaj të njëjtit është e iniciuar procedura e falimentimit, përkatësisht e likuidimit. *Nema dokaza da je ekonomski operator, sa brojem biznisa, proglašen pod stečajem ili nesolventan u protekle dve godine, i protiv istog, pokrenut postupak stečaja odnosno stečaja /likvidacije*

Kjo Çertifikatë lëshohet në kuptim të nenit 65 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 dhe 4.2 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. *Ovo Uverenje izdaje se na osnovu člana 65 stav 4 podstav 4.1 i 4.2 Zakona br.04/L-042 o Javnoj Nabavci Republike Kosova.*

E njëjta është kërkuar nga pala me qëllim të pjesëmarrjes në **TENDER** dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera. *Ista je zatražena od stranke s ciljem učešća za Tender, i ne može se upotrebiti za druge svrhe.*

Taksa është paguar sipas Tarifës për taksa gjyqësore në shumë prej pesë (5) **€,** e paraparë me nenin 12.17 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së, nr. 1/2017, në fuqi nga data 1.5.2017. *Taksa je plaćena po Tarifi za sudske takse u iznosu od 5€, predviđeno članom 12.17 Administrativnog Uputstva SSK-a, br. 1/2017, na snazi od dana 1.5.2017god.*

Afrim ADEMI

Referent i gjykatës / Referent Suda

Lidhur me raportin e vleresimit te miratuar nga ZPP mundë te konsiderojm si gabim procedural por që i njeti nuk përmban ndryshime material te percaktuar me Ne***nin 59 parg.4. pika. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë***, bazur ne ket pretendimin ankimore ne kete është **pjesërisht i bazuar**. Por duhet theksojm se OE i rekomanduar është përgjegjur atëher kur AK ka kërkuar dokumentin ne fjalë.

Përgjegjie e ekspertit shqyrtues dhe shtjellimi i pretendimit ankimor nr.4, lidhur me „ Kapacitetin teknik "

Në shpecifikimin teknik te Aneksit nr.1 te dosjes se tendertit ndër të tjera AK - KEK ka kërkuar si vijon:

"Fituesi potencial duhet të ketë kapacitete teknike për liferimin e 250 tonëve për 5 ditë , në rastet emërgjente 500 ton"

Autoriteti kontraktues ne dosjen e tenderti dhe ne specifkimin teknik nuk ka kërkuar qe operatoret ekonomik ne ofertim te dëshmojn kapacitetin e makineris për bartjen e mazutit, po ashut lidhur me kërkesëne AK operatori ekonomik i rekomanduar ka dorzuar deklaratë me shkrim lidhur me plotësimin e kushteve dhe kërkesave qe dalin nga aneksi nr.1 i DT si dhe ka bër vërtetimin dhe nënshkrimin e specifikimit teknik.

DEKLARATË

Nr2 i prokurimit	**KEK-23-6766-1-1-1**
Nr i brendshëm	**KEKO-23-045-111**

Titulli: FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)

Patroni SH.P.K deklaron se Mazuti do te liferohet konform afateve te kerkuara ne dosjen e tenderit si dhe do te dorezoj certifikaten e kualitetit sipas kerkeses se dosjes se tenderit.

Gjithashtu kompania do te sjelle edhe eprovetat sipas kerkeses se KEK sh.a.

Patroni SH.P.K

PATRONI SH.P.K

Duke pasur parasysh këtë konsiderojm se operatori ekonomik në këtë pikë plotëson kriterin e kërkuar ne dosjen e tenderti, dhe pretendimi ankimor është i **pa bazuar,** sa i përket pikës se pretendimit se AK është dashur të kërkoj sqarime për këtë pikë konstatojm se kjo qështje i përket autriteti konstraktues që te vendos për sqarime ose jo sa i përket kërkesave te tij, por që vlen të thekësojm se AK ne dosjen e tenderit nuk ka kërkuar Makineri për bartjen e Mazutit.

Nenin 72 i LPP thekëson: 2. Autoriteti kontraktues **mund** të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Dhe rrjedhimisht AK-KEK nuk ka par te obligueshme që të kërkoj sqarime shtes për një kërkes të cilën nuk e ka kërkuar ne dosjen e tenderti e as ne Anesin nr.1 lidhur me posedimin e Makineris bartëse për MAZUT.

Përgjegjie e ekspertit shqyrtues dhe shtjellimi i pretendimit ankimor nr.5 "Lidhur me deklaraten e origjinës se mazutit,,

Në dosjen etenderti ne Aneksin nr.1 Autorteti kontraktues ka cekur ,,**OE përmes nje deklarate duhet te deklarohet lidhur me vendin e origjinës se Mazutit dhe Prodhuesin,,**

Operatori ekonomik i rekomanduar ka dorzuar dy (2) deklarata me shkrim me tekstin si në vijim:

Titulli: FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)

Patroni SH.P.K deklaron se Mazuti do te liferohet konform afateve te kerkuara ne dos
tenderit si dhe do te dorezoj certifikaten e kualitetit sipas kerkeses se dosjes se tenderi

Gjithashtu kompania do te sjelle edhe eprovetat sipas kerkeses se KEK sh.a.

Po ashtu i njeti ka dorzuar edhe deklartatën për specifkimin teknik te kerkuar me Anesin nr. 1 duke theksuar se ploteson kriteret e specifkuara me tekstin si në vijim:

DEKLARATË

Nr1 i prokurimit	**KEK-23-6766-1-1-1**
Nr i brendshëm	**KEKO-23-045-111**

Titulli: FURNIZIM ME LËNDË DJEGËSE PËR KALDAJË – MAZUT(Fuel Oil 1.0%)

Patroni SH.P.K deklaron se produkti i ofruar eshte konform kerkesave dhe i ploteson te gjitha specifikat teknike sipas Aneks 1 te dosjes se tenderit.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE TË MAZUTIT

	Njësija	Mazut i rëndë	Mazut i mesëm	
Vlera kalorike	Kcak/kg	9500	9500	
Dendësija në 15 ^{0}C	Kg/dm^3	0.95	0.95	
Viskoziteti në 100 ^{0}C	^{0}E/cst	7.0/53	3.0/21	
Pika e ndezjes	^{0}C	min. 100	min. 80	
Lagështija dhe të dhënat	%	max.2.0	max.1.5	e ngurta
Hiri	%	max. 0.20	max. 0.20	
Sulfuri i gjithmbarshëm	%	max 1	max.1	
Treguesi Conradson	%	max 10.0	max 15.0	

OE përmes nje deklarate duhet te deklarohet lidhur me vendin e origjinës se Mazutit dhe Prodhuesin.

Tenderuesi duhet të jetë në pajtueshmëri me të gjitha specifikimet e shënuara në këtë listë. Çdo kërkesë jo e përmbushur do të eliminojë tenderin për pjesën e plotë. Ju lutem kontrolloni nëse tenderi juaj plotëson secilin nga specifikimet teknike të përshkruara më lartë.

Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është [±30%]

PATRONI

B27 DOSJA E TENDERIT PËR KONTRATËN PUBLIKE KORNIZË – FURNIZIM - *PROCEDURË E HAPUR* 16

Ne këto deklarata nuk figuron teksti se nga është prejardhja e Mazutit te furnizuar, por nënjë dokument, Certifikaten e Kulitetit (Certificate of Quality) me **Nr.219/2023/RE e datës 19.07.2023**, thekësohët se Vendndodhja (lokacioni) i ngarkimit është **„HELPE lonia, Thessaloniki"** dhe parimisht i bije qe është edhe vendi i prejardhjes apo origjinës, po ashtu ne këtë certifikatë thekseohet edhe produkti i kërkuar që është **FUEL OIL** si dhe vendi i destinimit Kosovë.

Karakteristikat teknike te kërkuara ne aneksin nr. 1 për Mazutin siq janë (Dendesia 15 grad C, Viskoziteti në 100 grad C etj) po ashtu janë te cekura edhe ne këtë certifikatë që ne këtë rast ne cilësin e ekspertit me lën për të kuptuar se kemi të bëjm me produktin e njejt te kerkuar me aneskin nr.1 te DT-së.

Është në përgjegjësin dhe autonomin ligjore te autoritetit kontraktues që ne baze te Nenit 59 te LPP të bëj vleresimi, krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave qe të vendos mbi prnaueshmerin apo jo te këti dokumenti qe ka te bej me mazutin. Vlenë për të thekësuar se në këtë pikës AK ka vlersuar konform Nenit 59 dhe **Nenit 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi** duke pasur parasysh se as operatori ekonomik ankues nuk ka dorzuar deklarat per prejardhjen e

Mazutit, kurse operatori ekonomik i rekomanduar siq potencuam edhe me lart ka prezantuar Certifikaten e Kulitetit qe ceke edhe Vendndodhja (lokacioni) e Mazutit.

Në cilesin e ekspeti shqyrtues këtë pretendim ankimor e cilësoj si **te bazuar.**

Shih certifikaten e kualitetit:

MAKINSPECT

MAKINSPECT DOO SKOPJE
Bul. Partizanski odredi 17 A-1/1
tel: 389 2 3127 067;
e-mail: info@makinspect.com.mk

CERTIFCATE OF QUALITY

Certificate no./Certificate date. 219/2023/RE; 19.07.2023	Location of loading/inspection: HELPE Ionia, Thessaloniki	Customer/Receiver: PATRONI SH.P.K.	Date of sampling: 22.05.2023
Object (rail, car tank plates): SK-6258-AI/SK-991-TB	Date of loading/inspection: 19.07.2023	Quantity as declared by rafinery: 35.710 kg ; 36.940 lit	No of testing: 0483/23
Transporter: GOSV TRANS	Product: FUEL OIL	Location of discharge: KOSOVO	No of sample/No of tank: 251/23; TK-827

PROPERTY	UNITS	RESULTS	METHODS
*Density at 15^{0} C	g/ml	0,9550	EN ISO 3675
Sulphur content	% m/m	0,892	ASTM D 4294
Viscosity at 50^{0} C	mm^{2}/s	267,0	ASTM D 445
Viscosity at 100^{0} C	mm^{2}/s	26,21	ASTM D 445
Flash Point	^{0}C	103,9	ASTM D 93
Pour point	^{0}C	-3	ASTM D 97
Water and sediments	% v/v	0,2	ASTM D 1796
Water by distillation	% v/v	0,0	ASTM D 95
Carbon residue	% m/m	10,19	EN ISO 10370
Ash	% m/m	0,034	ASTM D 482
Net heat of combustion	MJ/kg	41,13	ASTM D 4868
Gross heat of combustion	MJ/kg	43,58	ASTM D 4868

Note: This report is issued and is valid only for the sample taken by MAKINSPECT which is submitted for analisys in an accredited laboratory. The quantity stated above is according documentation issued by Greek Customs, Hellenic Petroleum and Rafinery OKTA. With this report MAKINSPECT does not guarantee the accuracy of the results of the analisys, but only that the methods used in the analisys and the obtained results are the same that are listed and received during the testimony.

*Analysis performed in Hellenic Petroleum 576; 21.05.2023
Analysis performed in OKTA REFINERY, Skopje, report number 0483/23 ;dated 26.05.2023

Approved by
MAKINSPECT LTD

МАКИНСПЕКТ ДОО

Përgjegjie e ekspertit shqyrtues dhe shtjellimi i pretendimit ankimor nr.6, lidhur me „ Cmimin "

Në te dosjes se tenderit te publikuar ne e-prokurim nga AK , njoftimit për kontratë si dhe Deklaratës se nevojave dhe përcaktimit te disponueshmeris se fondeve planifikimi buxhetit është **4,200,000.00 euro**

Vlera e parashikuar	2.6	**4,200,000.00 Euro**

Po ashtu në pikën 3.1 te dosjes se tenderit kriteri për dhënie te kontratës ka qenë:

Kriteret e Dhënies	31.1	Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët ☒

Kurse oferta e operatorit ekonomik te rekomanduar është **4,699,058.45 euro , 367,322.20 euro** më e ulët se sa oferta e dytë (e OE Ex Fis) dhe pasur parasysh planifkimin e autoriteti kontraktues oferta e operatorit ekonomik te rekomanduar nuk mundë që te konsiderohët në këtë rast si çmim ab-nomralisht i ulët dhe pretendimi ankimor për këtë është i **pa bazuar.**

Ne bazë te RRPP Nr.001/2022 Neni 41 pika 41.3 nën pikat (i), (ii) dhe (iii) citohët:

i.) çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve tëpërgjegjshëm;

ii.) çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;

iii.) janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë

Dhe bazuar ne këtë në as njërin variant nuk dëshmohët ne as një kalkulim se oferta është abnormalisht me çmimin e ulët.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke pasur parasysh sqarimet e lartëcekura dhe bazuar ne zhvillimin e procedurës se prokurimit dhe dokumentacionit te prezantuar eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **refuzohet** dhe vendimi i AK -së mbetet në fuqi**.**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Ex Fis**

Lulzim Bajrami